

BLERTA XHEKO

RRETH VARGJEVE FOLJE – EMËR VEPRIMI, EMËR VEPRUESI – MBIEMËR PREJFOLJOR NË FJALORË SHQIP – ANGLISHT DHE ANGLISHT-SHQIP

Gjeografia e leksikografisë dygjuhëshe e shqipes është shumë e gjerë, ajo lidhet me gjuhët e popujve që banojnë që nga Amerika e deri në Japoni. Fjalorët dygjuhësh të saj cekin thuajse të gjitha gjuhët indoevropiane: *anglisht, bullgarisht, çekisht, danisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, italisht, kroatisht, maqedonisht, norvegjisht, polonisht, rumanisht, rusisht, serbisht, sllovenisht, spanjisht, suedisht*. Duhet të pranojmë faktin se, veçanërisht shekulli XX dhe ky fillimshekulli e zgjeroi gjeografinë e leksikografisë shqipe dhe për gjuhë joindoevropiane, si: *arabisht, estonisht, hungarisht, kinezisht, romisht, turqisht* etj.¹

Shqipja përballjen kryesore sot e ka me anglishten, për shumë arsye. Vlen të përmendet këtu se ajo është gjuhë me përparësi në të gjitha shkollat e nivelit parauniversitar, si dhe gjuhë me përparësi për të ndjekur studimet e larta në Republikën e Shqipërisë. Kjo patjetër kërkon hartimin e fjalorëve vëllimorë e doracakë, të fjalorëve për në tavolinë dhe të fjalorëve studentorë të mbartshëm në çantë. Por hartimi i tyre kërkon dhe profesionistin dhe leksikografin, sepse shumë shpesh na bien në dorë fjalorë që janë hartuar jo vetëm nga dashamirës të anglishtes apo të shqipes, por dhe nga amatorë në gjuhë.

Hartimi i një fjalori dygjuhësh nuk nënkupton marrjen në mënyrë mekanike të një lëndë leksikografike të një gjuhe dhe gjetja e barasvlerësve të fjalëve në gjuhën tjetër. Të ishte kaq e lehtë, të gjithë do të hartonin fjalorë.

Në Leksikografinë dygjuhëshe të shqipes lagjja e fjalorëve anglisht shqip- dhe shqip anglisht është nga më cilësoret dhe më vepra që me të vërtetë janë vlerësuar brenda dhe jashtë kufijve. Ne mund të përmendnim disa nga fjalorët dygjuhësh që ka përdoruesi shqiptar në duar, si: *Fjalor anglisht-shqip* (1986) hartuar nga Ilo Stefanllari; *Fjalor shqip-anglisht* (1988) hartuar nga Ilo Duro dhe Ramazan Hysa, *Fjalor anglisht-shqip*

¹ Shih më gjerë J. Thomai, “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 11.

(1999), hartuar nga *Ramazan Hysa; Fjalor frazeologjik anglisht-shqip* (1998), hartuar nga *Ilo Stefanllari; Fjalor shqip-anglisht i Oksfordit* (2000), me rreth 70.000 njësi, hartuar nga *Leonard Newmark; fjalorë të vëllimshëm anglisht-shqip e shqip-anglisht janë hartuar nga Pavli Qesku: Fjalor shqip-anglisht* (1999), me rreth 45.000 fjalë, *Fjalor anglisht-shqip* (2000), *Fjalor anglisht-shqip* (2002), me rreth 120.000 njësi e me 600.000 shembuj e idioma etj.

1. Rreth vargjeve *folje – emër veprimi, emër vepruesi – mbiemër në fjalorët shqip – anglisht*

Si në anglishte, ashtu dhe në shqipe, te vargjet paradigmatiche fjalëformuese që kanë në përbërjen e tyre **folje – emër veprimi – emër vepruesi – mbiemër prejfoljor** vërehet se *formimi morfematik dhe motivimi semantik në këto vargje kanë gati - gati veçori të përbashkëta*, duke shpërfaqur kështu tipologji të njëjtë semantike.

Vargjet paradigmatiche fjalëformuese dalin dylojëshe:

a. *Vargje të hapura*, që nënkuptojnë mundësinë e shtimit të njësive të reja në mënyrë të papërcaktuar, pra vargje që nuk e ruajnë simetrinë e krijimit të njësive të reja.

b. *Vargje të mbyllura*, të cilët kanë simetri formimi dhe numër të njëjtë gjymtyrësh (fjalësh), të motivuara nga tema fjalëformuese **tip**.

Vargu *folje – emër veprimi – emër vepruesi – mbiemër prejfoljor* nuk duhet kuptuar sikur një *folje* krijon një *emër veprimi*, emri i veprimit krijon një *emër vepruesi*, emri i vepruesit krijon një *mbiemër prejfoljor*. Jo, marrëdhëniet këtu janë në formë **tufe**: *folje – emër veprimi, folje - emër vepruesi, folje - mbiemër prejfoljor*.

Shqipja, ndryshe nga anglishtja, del më e ndërlikuar në këtë proces, sepse shqipja si gjuhë me eptim shumë të zhvilluar, ka zhvillime diatezore tejvajtëse, të cilat foljen në vetvetore e kthejnë në njësi të re leksikore. Kjo duket sidomos te formimi i mbiemrave prejpjesorë. Në anglishte vargu shpesh është (ose duhet konceptuar) si katërgjymtyrësh *folje – emër veprimi - emër vepruesi – mbiemër prejpjesor*, kurse në shqipe është pesëgjymtyrësh **folje – folje në vetvetore – emër veprimi - emër vepruesi – mbiemër prejpjesor**.

Kjo ka rëndësi për pasqyrimin leksikografik të njësive që përfshihen në vargje të tilla, sidomos në fjalorët dygjuhësh.

1. Në *Fjalorin shqip – anglisht*, të hartuar nga I. Duro dhe R. Hysa, kemi një lëndë leksikore relativisht të paktë në numër, rreth 20.000 fjalë

dhe si shprehen autorët “fjalori mbetet një fjalor modest dhe nuk i pretendon të zgjidhë detyrat e një fjalori të tipit të mesëm”². Fjalori është hartuar pas botimit të dy fjalorëve shpjegues kombëtarë të shqipes, të *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980) me rreth 42.000 fjalë dhe 8.000 njësi frazeologjike dhe të *Fjalorit të shqipes së sotme* (1984) me rreth 35.000 fjalë e me 5.000 njësi frazeologjike. kështu ai kishte një lëndë të mjaftueshme për të përzgjedhur cilësisht lëndën që do të pasqyronte.

Në fjalor gjejmë vargje të plota, të cilat si jemi shprehur dhe më parë më shumë simetrike janë në shqipe, sesa në anglishte. Në këtë të fundit kemi një larushi emrash veprimi a vepruesi që janë formuar drejtpërdrejt nga folja përkatëse. Po përmendim si vargje të plota: *adoptoj - to adopt, adoptim - adoption, adoptues - adoptive father, i adoptuar - adopted; ndaj - to separate, ndarje separation, ndarës - separator, i ndarë - separated; zhyt - to plunge, zhytje - plunging, zhytës - plunger, i zhytur - plunged* etj.

Gjithashtu gjejmë dhe vargje të cungëta, të cilat mund të kenë bosh hapësirat e emrave të vepruesit, të emrave të veprimit, të mbiemrave prejpjesorë apo të kenë dy hapësira boshe (mund të mungojë p.sh., dhe emri i vepruesit dhe mbiemri prejpjesor): *adresoj - to address, adresim - addressing; bekoj - to bless, bekim - blessing, i bekuar - blessed; forcoj - to strengthen, forcim - strengthening, forcues - strengthening; furnizoj - to supply, furnizim - supplying, furnizues - supplier; ftoh - cool, ftohje - cooling; kris - to crack, krisje - cracking, i krisur - cracked; lyej - to paint / to colour, lyerje - painting / colouring; llatoj - to cocker / to pamper, i llatuar - cockered / pampered, populloj - to people, popullim - peopling; rralluj - to rarefy, rrallim - rarefying; rrëmbej - to kidnap, rrëmbim - kidnapping, rrëmbyes - kidnapper; rrëshqas - to slide, rrëshqitje - sliding; shtampo - to stamp, shtampim - stamping; shqyrtoj - to examine, shqyrtim - examination / examining, shqyrtues - examiner; verifikoj - to verify, verifikim - verification* etj.

Në vitin 2002 P. Qesku boton veprën *Fjalor shqip – anglisht*, me 45.500 njësi leksikore³, vepra më e madhe dygjuhëshe, ku shqipja është gjuhë e parë, e botuar deri në këtë kohë. Vepra pasuron dhe fjalësin e shqipes standarde, e cila deri në këtë vit fjalorin me vëllimin më të madh dhe me numrin më të madh të fjalëve kishte *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) me rreth 42.000 fjalë. Ky vëllim ka çuar dhe në plotësimin e vargjeve paradigamtike fjalëformuese më mirë se në çdo fjalor tjetër. Si

² I. Duro..., *Fjalor shqip – anglisht*, Tiranë, 1988, f. 3.

³ P. Qesku, *Fjalor shqip – anglisht*, Tiranë, 2002.

vargje të plota po sjellim: *garantoj* – to guarantee, *garantim* – guaranteeing, *garantues* – guarantor, *i garantuar* – guaranteed; *lexoj* – to read, *lexim* – reading, *lexues* – reader, *i lexuar* – read; *mbush* – to fill, *mbushje* – filling, *mbushës* – filler, *i mbushur* – filled; *ndaj* – separate, *ndarje* – separation, *ndarës* – separator, *i ndarë* – separated; *palos* – to fold, *palosje* – folding, *palosës* – folder, *i palosur* – folded; *përthyej* – to deflect, *përthyerje* – deflection, *përthyerës* – deflector, *i përthyer* – deflected etj.

Vargje të paplota: *fishk* – to wither, *fishkje* – withering, *i fishkur* – withered; *holloj* – to thin, *hollim* – thinning, *i holluar* – thinned; *lirësoj* – to cheapen, *lirësim* – cheapening; *liroj* – to free, *lirim* – freeing, *i liruar* – freed; *lodh* – to tire, *i lodhur* – tired; *mbyt* – to drown, *mbytje* – drowning, *i mbytur* – drowned, *palëzoj* – to pleat, *palëzim* – pleating;

2. Rreth vargjeve folje – emër veprimi, emër vepruesi – mbiemër në fjalorët shqip – anglisht

Po ndalemi në dy fjalorë që janë të tipave të ndryshëm dhe të hartuar në kohë të ndryshme:

a. Në vitin 1986, I. Stefanllari boton *Fjalor anglisht – shqip*. “Ky fjalor është një përpunim i thellë, i zgjeruar dhe i përmirësuar i botimit të vitit 1966 dhe përmban 30.000 fjalë. Gjatë përpunimit të këtij fjalori janë shfrytëzuar disa fjalorë të gjuhës së sotme shqipe, angleze, dygjuhësh dhe shpjegues, sidomos “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (Tiranë, 1980) si dhe fjalorë të ndryshëm terminologjikë, botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë”⁴. Vepra është ndër fjalorët më të mirë që ka shqipja për anglishten, jo për numrin e leksemave, por për saktësinë e gjetjes së fjalëve si barasvlerës në shqipe.

Në *Fjalor* kemi vargje të plota, të cilat janë të pakta, si *draw* – *skicoj*, *vizatoj*, *drawer* – *vizatues*, *drawing* – *vizatim*, *drawn* – *i skicuar*, *i vizatuar*, *sow* – *mbjell*, *sowing* – *mbjellje*, *sower* – *mbjellës*, *sowed* – *i mbjellë*; etj.

Vargjet e paplota janë në shumicën dërrmuese, si *adjure* – *adjuration*; *adjust* – *rregulloj*, *përshtas*, *adjuster* – *rregullues*, *adjustment* – *rregullim*, *adjustment* – *rregullues*; *confound* – *përziej*, *ngatërroj*, *prish*, *confounded* – *i hutuar*, *i urryer*, *confuse* – *ngatërroj*, *confussion* – *ngatërrim*; *dro find* – *gjej*, *finding* – *gjetje*, *finder* – *gjetës*, *model* – *modeloj*, *modeling* – *modelim*; *ingather* – *grumbulloj* të lashtat – *ingathering* grumbullimi i të

⁴ I. Stefanllari, *Fjalor anglisht – shqip*, Tiranë, 1986.

lashtave, oppress – shtyp, mundoj, oppressing – shtypje, oppressor – shtypws; persecute – persekutoj, pwrndjek, persecution – persekutim, pwrndjekje, persekutor – persekutues, pwrndjekws, steal – vjedh, stealing – vjedhje, stolen – i vjedhur etj.

b. *Fjalori anglisht – shqip* i P. Qesku: Fjalori, sipas autorit, ka rreth 120.000 fjalë në anglisht dhe gjegjëset në shqip⁵. Por në shqipe shumë shpesh nuk kemi simetri vargjeshe dhe fushën leksikore të vargut të anglishtes e mbulojnë dy a më shumë fjalë të shqipes. Kjo besojmë se vjen nga që shqipja nuk ka fjalor të tipit të madh që do të kishte potencialisht një fjalës që do t'i përgjigjej fjalësit të anglishtes. Gjithashtu hartuesi do ta kish më të lehtë punën leksikografike që të mos ngatërrohen nuancat a kuptimet leksikore të fjalëve:

Vargje të plota: *elect – zgjedh, elected – i zgjedhur, election – zgjedhje, elector – zgjedhës; record – regjistroj, recorded – i regjistruar, recording – regjistruar, recorder regjistruar; seed – hedh farë (mbjell), seeded – e farëzuar, seeding – farëzim, seeder – hedhës i farës (mbjellës); split – çaj, splitting – çarje, splitter – çarës, splited – i çarë, sink – humbon, fundoset, sinking – mbytje, fundosje, sunk – i mbytur, i fundosur, sinker – gërmues etj.*

Vargje të cungëta: *clarify – qartësoj / sqaroj, clarifying / clarification – sqarim, qartësim, clarifier – sqarues / shpjegues; cement – çimentoj, cemented – i çimentuar, cementation – çimentim; combine – bashkoj / përbëj, combined – i bashkuar / i bashkërenduar, combining – përbërje, combiner – rregullues shpejtësie; develop – zhvilloj, developing / development – zhvillim, shfrytëzim, developer – vegël (për zhvillimin e muskujve), preparat zhvillimi, kompani ndërtimi; eject – hedh, shkarkoj, shpronësj, ejection – hedhje, shkarkim, shpronësim, ejectionment – hedhje, shkarkim (vullkanik), shpronësim, ejector – hedhës, dëbues etj.; loosen – zgjidh / shkrifëroj, loosening – zgjidhje / shkrifërim, loosener – zgjidhës / shkrifëruar; mat – ashpërsoj, matting – ashpërsim, matted – i ashpërsuar; speak – flas, speaking – të folurit, speaker – folës; splash – laturis, splashing – laturisje, splasher / sprucator; truncate – trungëzoj, truncated – i trungëzuar, truncation – trungëzim etj.*

Si përfundim, mund të themi se pasqyrimi i njësive që formojnë vargun folje – emër veprimi, emër vepruesi – mbiemër prejfoljor, në fjalorët dygjuhësh në fjalorë shqip – anglisht dhe anglisht-shqip, nuk është

⁵ P. Qesku, *Fjalor anglisht – shqip*, Tiranë, 2002.

thjesht një veprim mekanik. Hartuesi duhet të zotërojë shumë mirë të dyja gjuhët, duhet të ketë njohuri të plota për leksikun, për morfologjinë, për fjalëformimin, për motivimin e brendshëm të fjalëve në shqipe dhe në anglishte. Kjo lidhet ngushtë pastaj me tipin e madhësinë e fjalorit, si dhe me llojin e përdoruesit dhe formatin e qarkullimit të veprës (format elektronik apo i printuar).